

NDËRRIMI I VENDIT TUAJ TË BANIMIT

kur ju shkaktohen kërcënime dhe dhunë në marrëdhëniet e ngushta

Ndoshta keni marrë ndihmë nga shërbimet sociale për t'u transferuar në një strehë për gratë apo në një akomodim tjetër të sigurt? Shumë gra dhe fëmijë kanë nevojë që të zhvendosen pas qëndrimit të tyre në akomodimin e sigurt, me qëllim që të planifikojnë për një të ardhme pa frikë dhe dhunë.

Kjo broshurë ju jep informacione rreth mundësive që keni për të krijuar kushtet për një të ardhme më të sigurt dhe se çfarë thotë ligji rreth përgjegjësisë së shërbimeve sociale për t'i ndihmuar viktimat e dhunës që të zhvendosen.

Këtu jepen gjithashtu edhe të dhënat e kontaktit për Strehën e Grave ALVA që mund t'ju ndihmojë me kërkesën tuaj dhe me kontaktet e tjera me autoritetet. Këtu mund të merrni gjithashtu këshilla, mbështetje dhe përgjigje për pyetjet tuaja rreth mënyrës se si mund të përdoret legjislacioni.

Informacioni ka si objektiv ato prej jush të cilave:

- u shkaktohen kërcënime apo dhunë dhe që kanë nevojë të krijojnë kushtet për një të ardhme më të sigurt diku tjetër
- punojnë në një strehë për gratë ose një akomodim tjetër të sigurt dhe bien në kontakt me gra të abuzuara dhe fëmijët e tyre
- punojnë brenda shërbimeve sociale, qendrave të shëndetit dhe kujdesit mjekësor, shkollave, etj. dhe që u duhet të dinë ligjet dhe rregulloret që aplikohen për zhvendosjen

Ligji suedez për shërbimet sociale, Kreu 2 a, Neni 8, pika 2

Këto rregullore hynë në fuqi në vitin 2011 për t'u siguruar mbështetje personave të cilëve u është shkaktuar dhunë ose abuzim tjetër. Rregulloret i japin një personi të drejtën të kërkojë mbështetje dhe ndihmë, duke përfshirë strehimin, në komunën në të cilën ai ose ajo dëshiron të zhvendoset.

Për kë zbatohen rregulloret e reja?

Ende nuk ka rregulla krejtësisht të qarta, përveçse që personi në fjalë duhet të ketë qenë viktimë e dhunës. Megjithatë, sipas udhëzimeve, rregulloret aplikohen për personat të dhënat personale të të cilëve janë të mbrojtura dhe që nuk janë në gjendje të aplikojnë personalisht për strehim. Është veçanërisht e rëndësishme që të merren në konsideratë nevojat e fëmijëve.

Si mund ta përdor legjislacionin?

Filloni duke gjetur se në cilën komunë dëshironi dhe jeni në gjendje të transferoheni. Ndoshta tashmë jetoni në një qendër strehimi në një komunë në të cilën dëshironi të qëndroni. Ndoshta ka ndonjë skenar kërcënimi në një zonë të Suedisë që do të thotë se ju nevojitet të transferoheni diku tjetër.

Merrni ndihmë nga personat te të cilët keni besim ose nga Streha për Gratë ALVA. Nëse është bërë një vlerësim i rrezikut nga policia ose shërbimet sociale, ky mund të ishte një pikë e mirë nisjeje.

Kërkesa duhet të jetë me shkrim

Kërkesën tuaj ju duhet t'ia paraqisni me shkrim shërbimeve sociale në komunën ku dëshironi të transferoheni, edhe nëse mund të aplikohet edhe kërkesa me gojë. Shpesh është e dobishme që të mendoni arsyet pse keni nevojë të transferoheni dhe ku - për këtë kërkoni ndihmë nga personat që e njohin situatën tuaj ose nga Streha e Grave ALVA.

Vendimi i shërbimeve sociale

Ju gjithmonë keni të drejtën të merrni një vendim me shkrim nga shërbimet sociale. Nëse nuk jeni e kënaqur me vendimin, keni të drejtën ta apeloni atë.

Apelimi duhet të jetë me shkrim dhe duhet të dorëzohet brenda 3 javëve nga data e marrjes së vendimit.

Lexojeni vendimin me kujdes, shkruani me fjalët tuaja se pse nuk jeni dakord me arsyet e refuzimit dhe dorëzoheni apelimin në kohë. Nuk është nevoja të shprehni në ndonjë mënyrë të veçantë. Shkruani atë që dëshironi të thoni dhe përshkruani situatën tuaj me sa më shumë detaje që të jetë e mundur. Mos i bëni në mënyrë të përgjithshme përshkrimet tuaja – përshkruajini ndjenjat dhe përvojat tuaja qartë dhe nëse është e mundur jepni edhe shembuj.

Sërish, pyesni nëse ju nevojitet ndihmë!

Shërbimet sociale mund ta zhvillojnë kërkimin për ju (Kreu 2 a, Nenet 10 dhe 11 SoL)

Është gjithashtu e mundur që shërbimet sociale të kërkojnë një transferim në një komunë të re ku ju dëshironi të jetoni. Nëse një punonjës social po ju ndihmon me planet tuaja, mund të kërkoni ndihmë për transferimin në vend që të bëni personalisht kërkesë në komunën e re.

Nëse komuna e re nuk i është përgjigjur punonjësit social brenda një muaji, ose nëse dy komunat nuk bien dakord, punonjësi social mund të bëjë në vend të kësaj një kërkesë për transferim përmes IVO (Inspektorati i Shëndetit dhe Kujdesit Social). IVO do të marrë një vendim brenda tre muajve.

Ka diçka tjetër që dëshironi të dini ose keni nevojë për ndihmë praktike?

Streha e Grave ALVA shpërndan informacione rreth të drejtave të grave sipas Ligjit suedez për shërbimet sociale, kur atyre u shkaktohen kërcënime dhe dhunë në marrëdhëniet e ngushta dhe kanë nevojë të zhvendosen. Ne dëshirojmë t'i fuqizojmë gratë në aftësitë e tyre për të pasur influencë në situatën e tyre.

Brenda Strehës së Grave ALVA ne mund të ofrojmë ndihmë me formulimin e kërkesave, me apelimet dhe dokumentet e tjera. Ne gjithashtu u japim këshillë dhe mbështetje palëve të tjera të përfshira, të tilla si strehat e grave, shërbimet sociale, qendrat shëndetësore dhe të kujdesit mjekësor, etj.

Ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni!

Ne mirëpresim si individët ashtu edhe autoritetet që të kontaktojnë me Strehën e Grave ALVA për informacione të mëtejshme ose këshillë dhe mbështetje:

Tel: +46 (0) 705-08 44 31

info@alvakvinnojour.se

www.alvakvinnojour.se

